



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Analizë teksti e gjuhës B (1)

Ngarkesa: 6 kredite (= 60 orë)
Viti / Semestri : Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor , Gjuhë Angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndor: Të zhvillohen katër aftësitë gjuhësore: të folurit, të shkruarit, dëgjimi dhe leximi në gjuhën angleze. Të nxisë shprehjen e qartë dhe rrjedhshme në situata të ndryshme komunikimi. Të forcohet pavarësia në të nxënë dhe përdorimi i strategjive efektive të të nxënit. Të ndërtohet vetëdija për ndikimin e medias dhe burimeve të informacionit në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Të lexojë dhe analizojë tipe të ndryshme tekstesh (mediatikë, letrarë, shkencorë etj.).
2. Të kuptojë dhe interpretojë ndikimin e medias dhe informacionit në përmbajtjen dhe formën e teksteve.
3. Të zhvillojë mendimin kritik dhe aftësitë e të shkruarit përmes analizës së teksteve mediatike.
4. Të identifikojë dhe vlerësojë burime të ndryshme informacioni dhe mediatike.
5. Të analizojë dhe interpretojë në mënyrë kritike tekste të folura dhe të shkruara.

Rezultatet e pritshme:

1. Në përfundim të këtij kursi, studenti pritet të jetë në gjendje:
2. Të lexojë dhe interpretojë me saktësi dhe kuptueshmëri një gamë të gjerë tekstesh në anglisht.
3. Të shprehë mendime në mënyrë të rrjedhshme dhe të argumentuar në gjuhën angleze të shkruar dhe të folur.
4. Të përdorë në mënyrë funksionale strukturat gramatikore dhe leksikore të gjuhës.
5. Të analizojë dhe vlerësojë kritkisht përmbajtje të ndryshme nga media dhe burime të tjera informacioni.
6. Të shkruajë tekste të ndryshme sipas situatave të komunikimit dhe qëllimit të caktuar..